



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Integrimit European
Ministarstvo za Evropske Integracije/Ministry of European Integration

Ministria e Integrimit European duke u bazuar ne Ligjin për Shërbimi Civil të Republikës se Kosovës L.Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren nr 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit ne Shërbimin Civil te Republikës se Kosovës shpall konkurs :

Divizioni i Buxhetit dhe Financave

Zyrtar i lartë Financiar
Referenca e titullit të punës (MIE-DFSHP-012)
Koeficienti : 8
Vendi: Prishtinë

Qëllimi vendit të punës:

Te ndihmoi ne propozim buxhetin afatmesëm te Ministrisë, të bëjë propozimin për vitin e ri fiskal, të hartoj raporte të ndryshme financiare në të njëjtën kohe të monitoroj të gjitha çështjet administrative në lidhje me Divioni për Buxhet dhe Financa.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bënë regjistrimin softuerik të transaksioneve buxhetore dhe autorizon shpenzimet;
- Përcjellë dhe barazon mjetet buxhetore në nivel të ministrisë, departamenteve dhe njërive më të vogla në kuadër të ministrisë;
- Përgatit pasqyrat financiare të Ministrisë;
- Merr pjesë në hartimin e të gjitha Projekt-Ligjeve, Projekt rregulloreve dhe dokumenteve tjera ligjore të cilat kërkojnë vlerësimin e ndikimit financiar;

- Bënë barazimin analitik të shpenzimeve buxhetore në emër të vijave të përcaktuara buxhetore;
- Përgatit librat analitik të cilat ia prezanton udhëheqësit të departamentit;
- Përgjigjet për përpikërinë e të dhënave në kategorinë e shpenzimeve;
- Jep këshilla, propozon zgjidhje të problemeve të paraqitura gjatë procesit të punës, që janë pjesë e detyrave dhe përgjegjësi që dalin nga puna;
- Përcjellë kontrollimin e emrit të përfituesit dhe llogarisë bankare në sistem, apo SWIFT kodit në rastin e pagesave ndërkombëtare në baze të dokumentacionit përcjellës;
- Kryen punë tjera të cilat i merr nga eprori i drejtpërdrejtë.

Shkathtësitë e kërkua (kualifikimet, përvojat si dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)

- Diplomë universitare ose baçelor , Fakulteti Ekonomik
- Përvojë pune së paku tri vite
- Njohja e gjuhës shqipe dhe ose serbe
- Njohje e mirë e programeve kompjuterike (Microsoft Office, Internet, etj.)
- Shkathtësi komunikimi dhe aftësi për punë ekipore

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve

Formulari për aplikim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (rruga Nëna Terezë p.n.) gjithashtu mund të tërhiqen edhe nga Web Faqja e internetit të MIE-së.

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat, çertifikata që nuk jeni nën hetim etj, mund të dorëzohen:

- Drejtpërdrejtë në Divizionin e Burimeve Njërzore të MIE-së si dhe
- Përmes postës.

Aplikacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i plotësuar gabueshëm, do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të merret në konsiderim.

Kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione me të dhëna të sakta. Në rast të mosplotësimit të këtyre kërkesave ose ofrimit të informatave jo të sakta, aplikacioni refuzohet, gjithashtu përdorimi i formularëve jozyrtar rezulton në refuzimin e menjëhershëm të aplikimit.

Aplikacionet e pranuar pas afatit të caktuar, konsiderohen të pranueshme nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar(postuar) para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve.

Kohëzgjatja e emërimit-punësimit bëhet në përputhje me LSHCK, në të cilën është e përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër/ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data 25.09.2014 deri 09.10.2014 në ora 16.00.

Për informata shtesë mundë të kontaktoni Divizioni e Burimeve Njëzore të MIE-së , në telefonin: 038 200 27-006

Konkursi dhe kërkesa për punësim janë të publikuara edhe në Web-Faqene Ministrisë: www.mei-ks.net

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjestarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.